

**KUD: 347.9 (796.51) “1700/1800”  
94(496.51) “1700/1800”**

**Agron ISLAMI**

## **KADIU OSMAN DHE VARTËSIT E TIJ NË KOSOVË GJATË VITEVE 1700-1800**

Sipas ligjit osman të kohës, të gjithë qytetarët ishin të barabartë para kanunit. Personi që ndante drejtësinë ishte kadiu. Emërimi i kadinjëve bëhej me dekret sulltanor, ose nga përfaqësuesi kryesor i sulltanit në ejalet, kadiasqeri, me kusht që miratimi i emërimit nga ky i fundit të bëhej nga shejhulislami (dijetari islam). Kadiu, mund të shërbente në një kaza jo më shumë se dy vjet dhe kjo bëhej me qëllim të moskrijimit të miqësive të kadiut me personalitete të fuqishme të qytetit që do të mund të ndikonin në vendimet e këtij të parit.

Çështja e kadiut si person që ndante drejtësi në hapësirat shqiptare, në këtë rast edhe në Kosovë, është ndër temat shumë pak të trajtuar në historiografinë tonë. Me qëllim të plotësimit të këtij vakumi kemi synuar që në këtë punim të shkurtër të ofrojmë të dhëna dokumentare osmane mbi veprimtarinë e kadiut, naibit dhe muhzirit në Kosovën e shekullit XVIII, si kuadër kryesor i gjykatës osmane në këtë trevë.

### **Kadiu**

Të gjitha trevat që përfshiheshin nën sundimin osman drejtoheshin nga një subash, që përfaqësonte pushtetin administrativ-ushtarak, dhe një kadi që përfaqësonte institucionin e drejtësisë dhe këto emërimë bëheshin në kuadër të dy njësive administrative *seyfiye* (klasë e ushtarakëve) dhe *ilmije* (klasë e të shkolluarve).<sup>1</sup> Ky i fundit (kadiu) ishte edhe përfaqësuesi

---

<sup>1</sup> İber Ortaylı, “Kadı”, *DİA*. XXIV (2001), f. 69; Gazmend Rizaj, “Roli i kadiut në Sistemin Administrativ-Gjyqësor të Perandorisë Osmane gjatë shekujve XV-XVIII me vështrim të posaçëm në Arnautllëk”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr. 14-1984, f. 93-110.

më i rëndësishëm i klasës *ilmije* që ndante drejtësi në shtetin osman, që në terminologjinë e të drejtës islame (fikh) njihet si eminenti kryesor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas rregullave dhe drejtësisë së sheriatit (legjislacionit islam). Kadinjtë, të gjitha çështjet juridike dhe vendimet i merrnin bazuar në shkollën juridike të medhëhebit hanefi.<sup>2</sup> Sipas drejtuesve-imamëve të shkollës juridike hanefite, nuk ishte kusht që gjykatësi (kadiu) të ishte alim (dijetar). Ngase, ai kishte hapësirë juridike, njëherësh edhe obligohej që në çështjet e panjohura vendimit t'i merrte duke u bazuar në fetvanë (mendimin) e myftiut, nga i cili mund të kërkonte ndihmë juridike për këto çështje.<sup>3</sup> Megjithatë nga kadinjtë pritej dhe kërkohet që të njihnin veçoritë dhe karakteristikat e popullit që banonte në hapësirën e tyre administrative juridike të njohur si kaza, mentalitetin e tyre (*halet-i ruhiye*) dhe gjuhën e vendit, apo të paktën ta kuptonin atë.<sup>4</sup>

Kadiu ishte jo vetëm në krye të institucionit të gjykatës osmane, por edhe administratori më i madh i qytetit osman, kujdestar për rendin dhe qetësinë, kontrollor i vakëfeve. Ai prapa vetes kishte edhe përgjegjësit institucionalë dhe grupet sociale që kishin detyrë që ta ndihmonin në realizimin dhe përmbushjen e shërbimeve publike, sikur ishte rasti me naibin (zëvendës i kadiut), mimarin (arkitekt, i cili përkujdesej për ndërtimet në kaza), muhziri, i cili ishte përgjegjës për sigurinë dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore.

Rroga e kadiut në aktet juridike osmane quhej “xhihet” apo “vazife”. Pagesa ditore e saj ishte mes 150 dhe 400 akçeve, por shkonte edhe deri në 500 akçe në kadillëqe të rëndësishme<sup>5</sup>. Evlija Çelebiu shënonte se kadiu i Vuçitërnës paguhej “150 akçe në ditë”.<sup>6</sup> Sipas një organizimi të institucioneve të kadiut e kryer në vitin 1078/1667-1668 kadiu i Prishtinës dhe Mitrovicës ishin në rangut “*e tretë (salise)*”, të Prizrenit “*të katërt (rabia)*”, të Pejës “*kaza mes të ardhurave 150-200 akçe*”, i Novobërdës

<sup>2</sup> Abdülaziz Bayındır, *İslam Mahkeme Usulü*, İstanbul 1968, f. 33. Kadinjtë i trajtonin në gjykatat e tyre të gjitha çështjet e sheriatit dhe gjyqësorit në varësi të popullsisë dhe më shumë sipas vendimeve (ixhtihad) të medhëhebit hanefi.

<sup>3</sup> A. Refik Gür, *Osmanlı İmparatorluğu'nda Kadılık Müessesesi*, İstanbul 2017, 50.

<sup>4</sup> Şinasi Altundağ, "Osmanlılarda Kadıların, Salahiyeti ve Vazifeleri Hakkında", *VI. Türk Tarih Kongresi (16-20 Ekim 1961)*, Ankara 1967, f. 346; Gür, a.g.e., f. 63.

<sup>5</sup> Mustafa Akdağ, "Osmanlı Müesseseleri Hakkında Notlar", *DTCFD*, XIII(1-2), Ankara 1955, f. 48.

<sup>6</sup> Evliya Çelebi bin Derviş Mehmed Zilli, *Evliya Çelebi Seyahatnamesi Topkapı Sarayı Kütüphanesi Bağdat 304 Numaralı Yazmanın Transkripsiyonu-Dizini*, I. Kitap, haz. Robert Dankoff-Seyit Ali Kahraman-Yücel Dağlı, İstanbul 2006, f. 293.

dhe Bihorit “*afër gradave të përmendura*”, i Vuçitërnës (Vushtrrisë) dhe Gjakovës “*kaza mes të ardhurave 100-150 akçe*”, i Janovës (Janjevës), Trepçës, Alltunilit, Hasseve të Prizrenit, Moravës dhe Kaçanikut “*kaza mes të ardhurave 100-130 akçe*”.<sup>7</sup> Sipas regjistrit të gradave (*rytbe*) të viteve 1740-1741 për kazatë e Rumelisë, Prishtina ashtu si një shekull më parë, ishte në “*gradë të tretë (salise)*”.<sup>8</sup> Po ashtu edhe sipas regjistrave (*ruznamçe*) të kazaskerit të Rumelisë së shekullit të XVIII, kadinjtë në Kosovë ishin të rangjeve që varionin nga 150 në 400 akçe ditore.<sup>9</sup>

Bazuar në fermanët e dërguar, kadinjve të Vuçitërnës, Dukagjinit dhe Prizrenit në periudhën që ne kemi në studim,<sup>10</sup> kuptohet se ata mbulonin të njëjtat detyra që mbulonin edhe kadinjtë në qytetet dhe kazatë e sanxhaqeve të tjera osmane.

### Kompetencat e kadiut

Në kuptimin logjik, mund të mendohet se kadiu, i cili i përkiste kuadrit juridik islam (*ehl-i shariat*) nuk kishte të drejta mbi kategorinë apo njësinë e administratës ushtarake (*ehl-i yrf*). Megjithatë kadiu konsiderohej përgjegjës nga ana e padishahut “*në çështjet që kanë të bëjnë me rendin në vend dhe mbrojtjen e administrimit e rajave*”<sup>11</sup>, mund të ndërhynte në këto çështje edhe ndaj forcave ushtarake në qytet. Fermani i mëposhtëm, dërguar kadinjve të Prizrenit, Dukagjinit dhe Vuçitërnës (Vushtrrisë) e vërteton këtë gjë.

Në fermanin e datës Evail-i Rebiülevvel 1173/23 Tetor-1 Kasım 1759, shkruhet se megjithëse Abdullah pasha, mytesarifi i sanxhakut të Prizrenit e kishte grumbulluar taksën *imdadi hazerije* në kohë dhe pa mangësi (“*edada kusurları yoğiken*”) sjelljet e ekspozuara prej tij që konsistonin “*shëtitje fshat më fshat dhe kaza më kaza pa pasur ferman për këtë çështje, duke burgosur dhe lidhur në zinxhir fukarenjtë dhe të dobëtit*

<sup>7</sup> M. Kemal Özergin, “Rumeli Kadılıklarında 1078 Düzenlemesi”, *İsmail Hakkı Uzunçarşılı'ya Armağan*, Ankara 1976, f. 259-269.

<sup>8</sup> Ahmet Halaçoğlu, “1740-1741 Tarihli Yazma Esere Göre Rumeli Kazalarının Rütbeleri”, *XII. Türk Tarih Kongresi Bildirileri*, III. Ankara, 1990, f. 875.

<sup>9</sup> Levent Kuru, “Kazasker Ruznamçelerine göre 18. Yüzyılın ilk yarısında Rumeli'de Kadılık Müessesesi”, *Marmara Üniversitesi, Türkiyat Araştırmaları Enstitüsü*, (Doktora Tezi), İstanbul 2016, f. 294-350.

<sup>10</sup> BOA. AE.SMHD.I. Dos. nr. 00148/11048; BOA. A.DVNS.AHKR.d, 1-25, BOA. A.DVNS.MHM.d, 10, f. 71, 83.

<sup>11</sup> Mehmet İnbaşı-Eyüp Kul, *Balkanlarda bşr Türk Şehri Üsküp, Fetihden XVIII. Yüzyıla Kadar*, Ankara 2018, f. 190.

duke i marr rajasë në mënyrë abuzive akça, duke bërë zullum dhe armiqësi ndaj tyre pasi ka marr prej tyre ushqime dhe pije falas në mënyrë zullumqare (të dhunshme), në këtë mënyrë duke i bërë shkak që popullsia e varfër të shpërndahet dhe të braktisë vendbanimet e tyre”, ishin ankuar nga popullsia vendase dhe prej kadiut urdhërohej të ndalonte mytesarifin e Prizrenit nga akte të tilla dhe të mos e lejonte më të bënte gjëra të tilla (“men’ ve def”) <sup>12</sup>. Një ngjarje e ngjashme lexohet edhe në fermanin e datës Evail-i Cemaziyelevvel 1157/12-22 Qershor 1744, drejtuar kadinjve të Prishtinës. Në ferman qartësohej se banorët e fshatit Ferrali në kazanë e Prishtinës, ankoheshin se paria e vendit (*ayan ve ehl-i örf*) kërkonin prej tyre taksa të reja në kundërshtim me ligjin, edhe pse ata kishin paguar “taksat imdadi hazerije dhe seferije dhe të tjera taksa të caktuara me fermanin e sulltanit sipas hises që i kishte takuar gjithsecilit dhe ato ishin ala (e lartë), evsat (e mesme dhe edna (e ulët)”, prandaj urdhëroheshin kadinjtë që të ndërhyenin në këtë padrejtësi të realizuar nga zyrtarë të klasës sejfije (*ayan ve ehl-i örf*) dhe të gjykonin sipas ligjeve dhe të ndalonin grumbullimet e taksave abuzive <sup>13</sup>.

Në një ferman tjetër të datës 25 nëntor-4 dhjetor 1765, përmenden ankesat e ardhura në Stamboll se Kahraman pasha, i cili ishte kajmakami i sanxhakut të Dukagjinit së bashku me 6-7 mijë eshkija (plaçkitës) shqiptarë, ka mbledhur taksën e vlerës së zahiresë (*zahire paha*) nga nahijet e Alltunilisë dhe Hasit, kanë djegur banesat në çifliqet e Ibrahim beut, birit të Ahmet Pashës dhe 420 shtëpi banimi (hane) në 11 fshatra, si dhe kishin sekuestruar prodhimet bujqësore dhe bagëtitë që kishin gjetur aty. <sup>14</sup> Për këtë rast abuziv dhe dhunues urdhërohej hetimi i detajuar nga valiu i Rumelisë, shkarkimi i kajmakamit (Kahraman Pashës) dhe zëvendësimi i tij me një person tjetër nga Stambolli.

Duke qenë se kadiu vinte nga klasa e të shkolluarve, ai kishte rol kyç edhe në emërimet e shkarkimet e kuadrit fetar (të cilët, po ashtu vinin nga njësia administrative, *ilmiye*) si myderrizët, imamët, hatipët, myezinët, mytevelinjët etj. Kështu në aktin e datës 21 Muharrem 1152/30 Prill 1739 të lëshuar nga Stambolli, me shkresën e kadiut të Prishtinës, Salihut, në detyrën e imamatit në mesxhidin e Hasan Eminut në Prishtinë, emërohej Hyseni në vend të babait të tij, i cili ishte tërhequr nga detyra <sup>15</sup>. Një vendim tjetër i datës 10 Safer 1157/25 Mart 1744 vjen si rezultat i

<sup>12</sup> *Başbakanlık Osmanlı Arşivi (më tej, BOA) A.DVNS.AHKR.d*, 16, f. 75.

<sup>13</sup> *BOA. A.DVNS.AHKR.d*, 3, f. 127.

<sup>14</sup> *BOA. A.DVNS.AHKR.d*, 20, f. 132.

<sup>15</sup> *BOA. EV.HMH.d*, 3991, f. 12.

shkresës së kadiut të Prishtinës dhe ka të bëjë me myteveliuin e vakëfit të Ragipit në Prishtinë, ku pas vdekjes së Jusufit emërohej myteveliu i ri, Behrami<sup>16</sup>.

Një tjetër detyrë e kadiut në qytet ishte edhe kontrolli i vakëfeve, disa prej të cilave formoheshin në mënyrë që të siguronin përfitime materiale për anëtarët e familjes së vakëflënësit, i cili kishte të drejtë që të përcaktonte në aktin e vakëfnamesë se kush do të ishin administratorët e vakëfit që po themelonte<sup>17</sup>. Një rast i tillë ndodhi në Prizren në vitin 1180/1766. Sherife Emineja pasardhëse e Mehmet pashës, një nga familjet e njohura të lagjes, ankohej se e drejta e myteveliu të vakëfit të themeluar nga gjyshi i saj në Prizren kushtëzohej me “*bijtë e bijve*” prandaj kërkonte t’i jepej asaj e drejta e myteveliu<sup>18</sup>.

## Naibi

Naib, quhej ndihmësi apo zëvendësi i kadiut. Institucioni i naibit ekzistonte që nga themelimet e shtetit osman. Naibi i takonte kategorisë së administratës fetare të kategorisë *ilmije*, i cili arsimohej në medrese në një nivel të caktuar që të kishte bagazhin e nevojshëm për zgjidhjen e problemeve gjyqësore sipas rregullave të jurisprudencës islame (*fikh*) që do të përballej në kazanë që do të administronte. Meqë ishin në postin e zëvendëskadinjëve, ata propozoheshin nga kadinjtë e kazave përkatëse dhe emëroheshin nga kazaskeri i vjaletit. Pagesa e naibit bëhej nga të ardhurat e gjykatës, respektivisht nga pagesat e detyrueshme që merreshin nga palët për veprimet gjyqësore që kryheshin në gjyqin e kazasë. Nga këto të ardhura të gjykatës naibit i takonte 1/5 apo 1/6 e të ardhurave që merrte kadiu<sup>19</sup>.

Megjithëse mbulonte të njëjtat kompetenca që zotëronte kadiu në kazanë që administronte naibi, nga aspekti hierarkik ishte poshtë gradës së kadiut.<sup>20</sup> Naibi emërohej edhe në varësi të madhësisë gjeografike të kazasë ku emërohej kadiu. Në varësi të detyrës që mbulonin, naibët ndaheshin në gjashtë kategori që ishin: naib *kazaje*, *kadillëku*, *mevali*, *bab*, *ajak* dhe

<sup>16</sup> BOA. EV.HMH.d. 3991, f. 15.

<sup>17</sup> Leslie Peirce, "Maddi Dünya: İdeolojiler ve Sıradan Şeyler", *Erken Modern Osmanlılar*, editör: Virginia H. Aksan-Daniel Goffman, İstanbul 2011, f. 309.

<sup>18</sup> BOA. A.DVNS.AHKR.d. 16, f. 105.

<sup>19</sup> Mehmet İpşirli, "Naib", *DİA*. XXXII (2006), f. 312-313.

<sup>20</sup> İlber Ortaylı, "Osmanlı Kadısı'nın Taşra Yönetimindeki Rolü Üzerine", *Amme İdaresi Dergisi*, IX(1), Ankara Mart 1976, f. 98.

*arpallëk*<sup>21</sup>. Ashtu sikurse kadiu, edhe naibi përfshihej në emërimet e kuadrit fetar të xhamive. Në një dokument të vitit 1151/1739, naibi i Novobërdës që personi i cili parashtronte kërkesën që Hasani të emërohej hatip (ligjërues) në xhaminë e Sulltan Mehmetit II në Novobërdë në vend të Mehmetit, ish-hatipit i cili kishte vdekur.<sup>22</sup>

Sipas burimeve të shekullit XVIII naibët nuk mund të zgjidheshin (emëroheshin) nga populli vendas (*yerlüden na'ib olmak memnu*). Megjithatë, nevojat e organizimit juridik lejonte që në ndonjë raste të tejkaloheshin zbatimimi i rregullit në fjalë. Për shembull, në një akt të datës Evail-i Zilhixhe 1171/ 06-25 Gusht 1758, shohim se naibi me prejardhje nga Prizreni Pirolli (Pireoğlu), u shkarkua nga detyra e naibit, pas akuzave të popullit se ai merrte ryshfet dhe akçe në kundërshtim me ligjin.<sup>23</sup>

## Muhziri

Emri Muhzir vjen nga gjuha arabe dhe ka kuptimin e personit përgjegjës për “sjelljen e palëve në gjyq”. Pra, ngjason me policinë gjyqësore të ditëve të sotme. Padyshim që nuk mund të aludohet në një identitet plotësisht të njëjtë me policinë moderne të sotme, por ky krahasim bëhet vetëm për të krijuar një ide të përafërt mbi përgjegjësitë e muhzirit të gjykatës osmane në Kosovën e shekullit XVIII.

Për personat që duhet të paraqiteshin në gjyq, kadiu përgatiste fletëthirrjen (mürasele) dhe ishte nga përgjegjësitë e para të muhzirit që këtë fletëthirrje t’ia komunikonte personit apo personave që u bëhej ftesa për t’u paraqitur në gjykatë. Një tjetër detyrë e muhzirit ishte edhe mbajtja e sigurisë dhe rendit gjatë gjykimeve që bënte kadiu.<sup>24</sup>

Muhziri përzgjidhej nga popullsia vendase, nga persona të cilët kishin mbuluar detyra shtetërore më përpara. Muhziri nuk mund të zgjidhej nga njerëz të thjeshtë që nuk njihnin procedurat shtetërore. Emërimi dhe shkarkimi i muhzirëve ishte në kompetencën dhe autoritetin e kadiut, i cili kandidatët e përshtatshëm sipas tij, ia parashtronte qendrës në Stamboll dhe më pas emërimi zyrtarizohej përmes lëshimit të Berat-it.

<sup>21</sup> İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmiye Teşkilatı*, Ankara 1965, f. 121-124.

<sup>22</sup> BOA. AE.SMHD.I. Dos. nr. 14/798.

<sup>23</sup> BOA. A.DVNS.AHKR.d. 19, f. 142.

<sup>24</sup> Recep Ahışalı, “Muhzir”, *DİA*. XXXI (2006), 85-86.

Muhziri nuk kishte rrogë fikse, por paguhej nga pagesat e përcaktuara për shërbimet që kryheshin në gjyqin e shariatit<sup>25</sup>.

Informacionet për muhzirët në Kosovë janë të pakta, por në dy akte flitet për kryemuhzirin dhe muhzirin në gjykatën e Sherijes në Gjakovë. Akti i parë i datës Shevval 1119/ dhjetor 1707, ka të bëjë me rinovimin e beratit për detyrën e kryemuhzirit në gjykatën e Gjakovës-Alltunilisë, me emrin Ramadan dhe një akt tjetër i datës 15 Şevval 1230/20 shtator 1815 Naib Sejdiu paraqiste shkresën që Islami, i biri i Osmanit të emërohej muhzir në gjykatën e Gjakovës dhe Alltunilisë në vend të Mahmudit, të birit të Haxhi Ahmedit, i cili kishte vdekur<sup>26</sup>.


Nga shembujt e lartpërmendur vijmë në përfundim se në shek. XVIII në hapësirën e Kosovës, institucioni i kadiut ishte mjaft efektiv në nxjerrjen e vendimeve për të mirën e qytetarit, nënshtetas osman. Komunikimi i kadiut që shërbente në kazatë (qytetet) e Kosovës me qendrën (Stambollin), po ashtu ishte në nivelin e duhur, sidomos në çështjet që kishin të bëjnë me emërime të kuadrit nëpër institucione publike, apo edhe në realizimin e vendimeve që vinin nga qendra si rezultat i ankesave të qytetarëve. Njëherësh, përmes dokumentacionit të proveniencës osmane, pamë se kadiu vinte nga klasa e të shkolluarve *ilmije*, por që me dekret të veçantë përfaqësonte edhe kuadrin ushtarak - *askerijje* në kaza. Konform praktikës ligjore osmane në sanxhaqet që përbënin Kosovën vepronin edhe ndihmësit e kadiut, naibi dhe muhziri.

Lëndët arkivore të trajtuara në këtë punim shpërfaqin edhe një pasqyrë mbi jetën sociale dhe politike në Kosovë gjatë shekullit të fundit të periudhës klasike osmane (1700-1800). Për rezultat, shpeshherë qytetarët ishin shtrënguar që të braktisin vendbanimet e tyre si shkak i bashkëpunimit të zyrtarëve të gjykatës osmane me përfaqësues të klasës ushtarake lokale në dëm të popullit që përcilleshin edhe me taksa të shpikura nga këta zyrtarë.


<sup>25</sup> Akgündüz, Şerriyye Sicilleri, *ibid*, f. 72-73.

<sup>26</sup> VGMA. HD. 1192, vr. 35; HD. 1174, vr. 254.

Shtojcë:



Akti i kadiut të Prishtinës me emrin Salih mbi emërimin e imamit në mesxhidin Hasan Emin (viti 1739).



Akti i emërimit të kryemuhzirit në Gjykatën e Gjakovës dhe Alltunilisë me emrin Ramadan (viti 1707).

Agron ISLAMI

## SUMMARY

### **THE OTTOMAN KADI AND HIS SUBORDINATES IN KOSOVO, DURING THE YEARS 1700-1800**

All citizens were treated equally before the “Kanun (Qanun)”, according to the then-current Ottoman law. The magistrate of justice was “Kadi”. The appointment of the Kadi, was made by Sultan's decree, or by the main representative of the Sultan in “Ejalet”, “Kadiasqeri”, provided that “Sheikh Hulislami” (Islamic Scholar) approved the nomination. The limit on the length of the Kadi's service in a “Kaza” (administrative division), was set at two years in order to prevent the Kadi from developing relationships with influential city figures that would affect the Kaza's decisions. Magistrate official capacity of the Kadi's function, as a judge in the Albanian areas, respectively in Kosova, is among the very few topics studied by our historiography. In order to contribute for enlighten this issue, we provided Ottoman documentary data on the activities of “Kadi, Naib and Muhzir” in 18th century Kosovo, as the main officials of the Ottoman legal system in this region.